Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/1048

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vjosa Gradinaj Mexhuani-kryetare duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "AS Tech" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të KUVENDI I KOMUNES-KAÇANIK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)" me numër të prokurimit 652-23-12732-1-3-6, me 08/03/2024, mori:

Vendim

1.Refuzohet si e pabazuar ankesa e OE "AS Tech" SH.P.K. me nr. 2023/1048, e datës 25/12/2023, kurse vendimi i AK KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)" me numër të prokurimit 652-23-12732-1-3-6 **Vërtetohet.**

2.Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 15.11.2023, KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)" me numër të prokurimit 652-23-12732-1-3-6. Ndërsa me

datën 30.11.2023 AK ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Me 08.12.2023, OE " AS Tech " SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 13.12.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim

Me 25.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE " AS Tech " SH.P.K. me nr. 1048/23 lidhur me aktivitetin "Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)" me numër të prokurimit 652-23-12732-1-3-6.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marrë parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertes shqyrtuese ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertes, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertes, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues " AS Tech " SH.P.K. janë parashtruar si në vijim**:**

Ankuesi pretendon se "Fillimisht kemi kërkuar qasje ne oferte te rekomanduar por AK nuk na ka ofruar qasje, pastaj kemi bere kërkesën për rishqyrtim me datën 05.12.2023 me te vetmin pretendim se AK nuk na ka ofruar qasje. AK nuk merr Vendim te kërkesës për rishqyrtim por vetëm na ofron qasje ne oferte te rekomanduar përmes emalit. Nga qasja qe patëm shohim qe AK

ka shpërblyer një oferte te papërgjegjshëm, OE i rekomanduar nuk i ka plotësuar te gjitha kërkesat e dosjes se tenderit. Tek kërkesa për kushte te garantimit te dhëna 2 vite nga AK, OE nuk ka sjell dëshmi se ofron garancion 2 vite. Askund ne ofertën e tij nuk ka deklarate te garancionit qe OE te garanton për furnizimet e tij, ky është një kushte i dosjes se tenderit dhe mos plotësimi i tij e bene një ofertë te papërgjegjshme automatikisht. Ne vendimin e kërkesës për rishqyrtim AK këtë pretendim e hedh poshtë sipas tyre garancioni s'ka qene i cekur ne dosje dhe nuk mund te eliminohet oferta për diçka qe nuk është cekur, kjo nuk qëndron sepse ne faqen 6 te dosjes II.7 Kërkesat e garantimit: 2 vjeçare. shkruan shume mire kërkesa për garancion nga AK> Këtë e themi nga te gjitha praktikat e deritanishme sa i përket Garancionit te kërkuar, ku ne çdo rast te gjykuar një oferte është eliminuar nëse nuk ka ofruar garancion. OE ne oferte po ashtu nuk ka referenca te dorëzuara, nga vlerësimi qe i kemi bere dokumenteve qe kemi pasur nga qasja."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër, OE " AS Tech " SH.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 59 dhe 60 të LPP duke kërkuar nga Paneli Shqyrtues që të aprovohet ankesa si e bazuar, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje e AK - KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK ndaj kërkesës për rishqyrtim të OE " AS Tech " SH.P.K.– refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim sepse një tender si i përgjegjshëm do të konsiderohet nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit konform nenit 59 par. 4 i LPP. Andaj oferta nuk mund të refuzohet nëse një kërkesë e tillë nuk është e parashtruar në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29.12.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2023/1048, ndërsa me datë 05.01.2024 është dorëzuar raporti i ekspertes shqyrtuese me nr. 2023/1048 me rekomandimet si në vijim:"eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim."

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK deklaron se nuk pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertes shqyrtuese duke theksuar se "Vlerësimi është ne kundërshtim me nenin 6,7,56;59,60 të LPP-se respektivisht neni 25.1 40.12 të Rregullores nr. 001/2022 për prokurim publik., ndërsa OE është deklaruar se pajtohet me rekomandimin e ekspertes shqyrtuese.

Lidhur me pretendimet e OE " AS Tech " SH.P.K. ekspertja shqyrtuese përmes raportit nr. 2023/1048 ka vlerësuar si në vijim: Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin ankimor se OE i rekomanduar nuk ka ofruar garancion 2 vjeçar - nuk ka plotësuar kushtet e dosjes së tenderit, andaj duhet të shpallet i pa përgjegjshëm,pas analizimit, vlerësimit të shkresave të lëndës sqaron se, AK në vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ka deklaruar se garancioni nuk ka qenë kusht në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit.Përderisa pas verifikimit të dosjes së tenderit shohim se AK në DT tek neni II ka kërkuar garancion (Provë Dosja e tenderit). Gjithashtu vlen të theksohet se, asnjë produkt kohët e fundit nuk blehet pa garancion, kurse në ofertën e OE të rekomanduar nuk gjendet garancioni, andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar. Si përfundim, ekspertja shqyrtuese ka konstatuar se AK aktivitetin e prokurimit nuk ka vlerësuar konform nenit 59 të LPP-së, andaj rekomandoj që lënda të kthehet në rivlerësim.

Konstatimet e panelit shqyrtues-

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore lidhur me ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rregullimi i hapësirës rreth shtatoreve te katër Gjeneraleve ne lagjen Karagaq RITENDER" me numër të prokurimit 635-23-12223-5-2-1.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në ketë rast është prezantuar në detaje në raportin e ekspertizës së ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar të gjitha fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik. Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në ketë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhenë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Andaj, Paneli nuk i mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili ka shpjeguar në raportin e ekpertizës së tij, kështu që paneli shqyrtues e mbështet arsyetimin në kërkesën për ri-shqyrtim sa i përket pretendimit ankimore për të rekomanduarin sepse kjo kërkesë është kërkesë që duhet të realizohet në implementim të kontratës, don të thotë nuk është kërkesë e perzgjedhjes së fituesit. Kështu që duke u bazuar në nenin 56.3 të LPP citat, "Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit" dhe nenit 59.4 të LPP citat "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", andaj, rrjedhimisht paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi vendimin e AK, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional.

Andaj në ndajshtesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës bazuar edhe në neni 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se Autoriteti Kontraktues ka vepruar konform dispozitave ligjore të LPP, pasi që AK ka trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese te gjithë OE pjesëmarrës, duke u bazuar në dokumentacionin e prezantuar dhe dëshmitë dëshmuese me pas ka rekomanduar OE me ofertën më të lirë të përgjegjshëm. Paneli Shqyrtues vlerëson se vlerësimi i tenderit është kryer sipas kërkesave të specifikuara në njoftimin e kontratës dhe dosjes së tenderit. Andaj, Paneli Shqyrtues vlerëson se AK me të drejt ka shpërblyer OE e rekomanduar pasi që ka përmbushur gjitha kërkesat e parashtruara në dosjen e tenderit si dhe ka qenë tenderi me i përgjegjshëm me çmim me të ultë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet në tërësi si e pabazuae. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi me Klima (kondicioner)" me numër të prokurimit 652-23-12732-1-3-6.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën 1 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën 2 të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK**
- OE - **" AS Tech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: